

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
REAL BAILIFF SERVICE SH.P.K

NIPT L71710039A

Nr.771 Regj  
Nr. 2760 Prot

Tiranë, më 04.07.2019

URDHËR  
“PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”



Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit  
Adresa: Tirane  
Per dijeni: P.F. VLADIMIR SHEHU, Nipt L33318001M (0695130685)  
Adresa: Berat, Kutalli, Drenovice, Fshati Drenovice, godine 1-kateshe ne periferi te fshatit,  
Per dijeni: “Pik Industry” Sh.p.k NIPT L44324401A  
Adresa: Autostrada Lushnje - Fier, km 1

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr. 148, date 22.05.2019 i Gjykates se Rrethit Gjyqësore Berat, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 771, Datë 05.06.2019 kërkesën e kreditorit “Pik Industry” Sh.p.k NIPT L44324401A ndaj debitorit P.F. VLADIMIR SHEHU, Nipt L33318001M, në lidhje me titullin ekzekutiv:

- “Fature tatimore e shitjes” Nr. 755, date 31.08.2017, me Nr. Serie 49838997- 61,464 Leke;
- “Fature tatimore e shitjes” Nr. 771, date 10.09.2017, me Nr. Serie 49833463- 269,000 Leke.

Pas kryerjes se Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të detyrimit dhe fillimit te ekzekutimit te detyrueshëm, referuar nenëve 517 dhe 527 të K.Pr.Civile,

me Shkresën Nr. 2760 Prot, datë 25.06.2019 është dërguar Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative në QKB.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA:

Se pas verifikimeve te llogarive bankare rezulton se detyrimi eshte ekzekutuar teresisht.

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 32. Pikat (b,c) të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Heqjen e masës së Sekuestros Konservative, të vendosur me anë të shkresës Nr. 2760 Prot, datë 25.06.2019, mbi aktivet e pales debitore P.F. VLADIMIR SHEHU, Nipt L33318001M, me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

“REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
Eris SOTIRI